



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Sh.II.nr.318/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim dhe Energji Elektrike Sh.A (KESCO) me seli në Prishtinë, kundër debitorit Dion,s Las Vegas shpk nga Prizreni, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.818/23 të datës 13.11.2023, me datë 19.03.2024, mori këtë

A K T V E N D I M

REFUZOHET ankesa e kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim dhe Energji Elektrike Sh.A (KESCO) me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.818/23 i datës 13.11.2023, VERTETOHET

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.818/23 të datës 13.11.2023, e ka Pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Dion,s Las Vegas shpk nga Prizreni, dhe ka Shfuqizuar Urdhrin Përmbarimor P.nr.845/19 të datës 29.10.2019, të lejuar nga Përmbaruesi Rushit Hoxha.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbarimore, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozimin që të aprovohet ankesa e kreditorit në tërësi si e bazuar, ashtu që të ndryshohet aktvendimi i ankimuar, dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim P.nr.845/19 datës 29.10.2019, ose të prishet aktvendimi ankimor dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Kompania Kosovare për Furnizim dhe Energji Elektrike Sh.A (KESCO) me seli në Prishtinë, me datën 29.10.2019 ka paraqitur propozim për përbarim, kundër debitorit Dion,s Las Vegas shpk nga Prizreni, në bazë të dokumentit të besueshëm – Ekstraktit nga librat afariste, në shumë të përgjithshme prej 669.84€.

Përbaruesi Privat Rushit Hoxha nga Prizreni, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka caktuar urdhrin P.nr.845/19 të datës 29.10.2019 duke lejuar përbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm, Ekstraktit nga librat afariste, me të cilin ka obliguar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrin, t'ia paguaj kreditorit borxhin prej 669.84€, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga dita e kalimit të afatit për pagesë e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet përbarimore.

Debitori në prapësim të ushtruar kundër urdhrin përbarimor thekson se dokumenti mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri nuk është i përshtatshëm për përbarim ngase në të nuk tregohet kreditori dhe debitori dhe se nuk është vërtetuar se debitori ka pranuar shërbimet e kreditorit, Debitori nuk ka ndonjë kontratë me kreditorin dhe se i mungon legjitimiteti pasiv i palës në procedurë ngase që nga viti 2012 kur është paguar borxhi ndaj kreditorit, veprimtaria e biznesit është ndërprerë, ndërsa lokali është në pronësi të N.H., i cili e ka dhënë me qira personave tjerë që nga fundi i vitit 2012, kërkesa e kreditorit është parashkruar, i propozon gjykatës që prapësimin e debitorit ta aprovoj si të bazuar ndërsa urdhri përbarimor të shfuqizohet.

Kreditori në përgjigje në prapësim, ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit si të pabazuar, dhe ka shtuar se propozimi është paraqitur mbi bazën e ekstraktit ku është precizuar borxhi komulativ dhe jo i ndarë për çdo faturë. Pretendimet se lokali nuk është shfrytëzuar nga debitori dhe borxhi nuk i përket atij, janë të pabazuara ngase në historikun e konsumatorit nuk është pranuar ndonjë kërkesë për ndërrim të pronarit-shfrytëzuesit. Debitori ka bërë pagesën në vlerë 50€, andaj pagesa vullnetare është e mjaftueshme për të manifestuar pranimin e borxhit dhe rrjedhimisht është ndërprerë afati i përshkrimit në kuptim të nenit 368 të LMD-së, i propozon gjykatës që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar, ndërsa urdhri përbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.818/23 datës 13.11.2023 me të cilin e ka Pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Dion,s Las Vegas shpk nga Prizreni, dhe ka Shfuqizuar Urdhrin Përbarimor P.nr.845/19, të datës 29.10.2019, të lejuar nga Përbaruesi Privat Rushit Hoxha nga Prizreni.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar dhoma e shkallës së parë ka theksuar se urdhri mbi lejimin e përbarimit është lejuar në kundërshtim me nenin 38 par.1, ngase në propozim pe përbarim kreditori nuk i ka treguar të dhënat e nevojshme në drejtim të identifikimit të debitorit, duke mos treguar të dhënat tjera të debitorit. Në vlerësimin e gjykatës, vetëm përshkrimi i debitorit Dion,s Las Vegas shpk-H.G., pa treguar numrin e biznesit apo identifikues të debitorit, nuk është i

mjaftueshëm për identifikimin e saktë të debitorit, po ashtu nuk është e qartë nëse propozimi është paraqitur ndaj dy debitorëve dhe nëse është kërkuar përmbushja në mënyrë solidare prej tyre. Gjykata gjithashtu gjen se shumica e kërkuar për përmbushje në propozim për përmbarim nga kreditori, nuk përputhet me shumën e pasqyruar në ekstraktin mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri, për arsye se në propozim kreditori ka kërkuar përmbushjen e borxhit prej 669.84€ për periudhën 20.06.2019 deri 05.10.2019, ndërsa në ekstrakt rezulton se kjo pjesë e detyrimit është borxh i akumuluar për periudhën 31.03.2013 deri me 29.10.2019.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se dhoma e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbimore kur e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrit të përmbaruesit privat, me të cilin është caktuar përmbarimi i propozuar nga kreditori, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarimi është lejuar në bazë të dokumentit të besueshëm –Ekstraktit nga librat afariste DPZ 9043629, për periudhën kohore 31.03.2013 deri me datën 29.10.2019 i cili dokument ka shumën në total prej 4,553.96€, ndërsa propozimi për përmbarim përmban vlerën e borxhit shumën prej 669.84€ për konsumin e energjisë elektrike, në periudhën kohore 20.06.2019 deri me datën 05.10.2019, në bazë të cilës përmbaruesi privat ka zbatuar përmbarimin, e i cili dokument përmbarues sipas kësaj gjykate nuk përbën bazë juridike për caktimin e përmbarimit, ngase në kuptim të kontradiktave të dukshme sa i përket lartësisë së borxhit dhe periudhës kohore në akumulimin e borxhit, dokumenti i besueshëm si i tillë, nuk i plotëson kushtet ligjore nga neni 21 të LPP-së , në të cilin përcaktohet se “ *Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër*”. Ndërsa me nenin 29 par.1.3 të LPP-së përcaktohet se “ *Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: ekstraktet e verifikuara nga librat afariste*”.

Prandaj, bazuar në këto arsye, Dhomat e shkallës së dytë vlerëson se dhoma e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të bazuar në dispozita konkrete ligjore, ashtu që përfundimin juridik të dhomës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe në konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Dhomat e shkallës së dytë analizoi pretendimet e kreditorit por vlerëson se i njëjti nuk ka ofruar asnjë provë konkrete në mbështetje të tyre siç parashihet me nenin 69 par.4 të LPP, ashtu që të njëjtat i refuzoi si të pabazuara.

Përndryshe në procedurën përmbimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës

dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin

Kompetenca e Dhomës së shkallës së dytë, për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë, bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika c) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së dytë

K.Dh.Sh.II.nr.318/24 datë 19.03.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha